



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 mars 2015  
Nr. ref.:RK780/15

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI89/14**

Parashtrues

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,  
Rev. nr. 287/2013, të 18 dhjetorit 2013**

### GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), përfaqësuar nga z. Murat Lepaja.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 287/2013, të 18 dhjetorit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 7 mars 2014.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 287/2013, të 18 dhjetorit 2013, për të cilin parashtruesi nuk ka cekur ndonjë shkelje të dispozitave kushtetuese.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 21.4 të Kushtetutës dhe nenet 20 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme, Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 19 maj 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI89/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI89/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova.
7. Më 19 qershor 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës dhe znj. M. G. si palë e tretë në procedurë.
8. Më 23 korrik 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 25 korrik 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesi dorëzimin e fletëkthesës që dëshmon datën kur parashtruesi ka pranuar Aktgjykimin Rev. nr. 287/2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës.
10. Më 1 gusht 2014, parashtruesi dorëzoi dokumentacionin e kërkuar nga Gjykata.
11. Më 19 shtator 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesi dorëzimin e padisë për Konflikt Administrativ Ref. SP-575/06, të 2 nëntorit 2006 të parashtruar në Gjykatën Supreme të Kosovës, Aktvendimin e Gjykatës Supreme A. nr. 28881/2006, të 14 marsit 2007, dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ca. nr. 34441/2012 të 14 qershorit 2013, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë C. nr. 340/2008, të 26 prillit 2012.

12. Më 26 shtator 2014, parashtruesi dorëzoi dokumentacionin e kërkuar nga Gjykata, si dhe Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës A, 02, 100/2006 të 8 korrikut 2006, dhe Formularin e vlerësimit të kryerjes së punës për znj. M. G. të 23 nëntorit 2007.
13. Më 11 shkurt 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve në procedurën administrative**

14. Znj. M. G. ka qenë e punësuar nga 5 prilli 2001 deri më 31 dhjetor 2007, si zyrtare Ekonomiko - Financiare pranë Agjencisë Pyjore – Zyra regjionale në Pejë, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës.
15. Më 28 shkurt 2006, parashtruesi me Vendimin Ref. KE-61/06 suspendoi znj. M. G., me largim të përkohshëm nga puna. Parashtruesi i kërkesës konstatoi se znj. M. G. *“[...] gjatë kohës së punës nuk i ka përfill obligimet dhe detyrat punonjëse nga neni 30.1 paragrafi (b), (c), (d), (e) dhe (j) të Udhëzimit Administrativ nr. 2013/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës [...]”*.
16. Më 18 maj 2006, Komisioni Disiplinor i parashtruesit (Organi punëdhënës i Agjencisë Pyjore të Kosovës) mori Vendim Ref. KE-02/2/166/06 për ndërprerjen e punës së znj. M. G. duke vërtetuar: *“[...] se pas administrimit të provave shtesë e lartpërmendura ka rënë ndesh me Kodin e Shërbimit Civil të Kosovës, dhe është vërtetuar se nuk ka përfillur udhëzimet e arsyeshme të udhëheqësit të organit të punësimit, refuzon dhe saboton punën në shërbimin ekonomik financiar të specifikacioneve, faturave për fletëpagesa për pyjet publike dhe private, si dhe bënë shpifje dhe përdor fjalor banal dhe i fyen kolegët e vet të stafit teknik por nënçmon e fyen stafin e lartë të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përkatësisht Zyrën Rajonale të AKP-së në Pejë [...]”*.
17. Në një datë të pacaktuar znj. M. G. parashtroi ankesë në Komisionin për Ankesa të parashtruesit (Organit Punëdhënës të Agjencisë Pyjore të Kosovës).
18. Më 8 qershor 2006, Komisioni për Ankesa i parashtruesit të kërkesës mori Vendim nr. 02/2/174/06, për refuzimin e ankesës së znj. M. G.
19. Më 22 qershor 2006, znj. M. G. parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, kundër Vendimit (02/2/174/06), të Komisionit për Ankesa të parashtruesit të kërkesës.
20. Më 8 korrik 2006, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës me Vendimin A, 02, 100/2006 aprovoi ankesën e znj. M. G., si të bazuar dhe anuloi Vendimin (02/2/174/06) e Komisionit për ankesa të parashtruesit si dhe Vendimin (Ref. 02/2/166/06) e Komisionit disiplinor të parashtruesit të kërkesës.

21. Më 2 nëntor 2006, parashtruesi ka ngritur Kontest Administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër Vendimit (A, 02, 100/2006) të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.
22. Më 14 mars 2007, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin A. nr. 2881/2006 në konfliktin administrativ sipas padisë së parashtruesit, hedh poshtë padinë e parashtruesit si të palejuar duke vlerësuar [...] *se vendimi i kontestuar dhe procedura e cila i ka paraprirë marrjes së atij vendimi nuk e kanë karakterin e aktit dhe procedurës Administrative si parashifet me nenin 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative e duke pasur parasysh dispozitat e ligjeve të cekura më lartë gjen se kompetente për të vendosur në këtë kontest është Gjykata Komunale në Prishtinë [...]*”.
23. Më 26 nëntor 2007, znj. M. G. parashtroi ankesë në Komisionin për Ankesa të parashtruesit kundër vlerësimit të kryerjes së punës të 23 nëntorit 2007.
24. Më 30 nëntor 2007, parashtruesi i kërkesës me shkresën Ref. KE 934/07 njoftoi znj. M. G. për mosvazhdimin e kontratës duke u mbështetur në Rregulloren nr. 2001/36 mbi Shërbimin civil të Kosovës dhe Urdhëresën administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së cekur, dhe vlerësimin e punës nga shefi i Zyrës së AKP-së në Pejë.
25. Më 31 dhjetor 2007, Komisioni për Ankesa mori Vendim nr. 1604/13 për refuzimin e ankesës së znj. M. G. si të pabazuar dhe të paargumentuar.
26. Më 24 janar 2008, znj. M. G. parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.
27. Më 24 prill 2008, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës me Vendimin Nr. 815/08, refuzoi ankesën e znj. M. G. si të pabazuar dhe vërtetoi njoftimin Ref. KE-934/07, të 30 nëntorit 2007 dhe po ashtu vërtetoi Vendimin (nr. 1604/13) e Komisionit të Ankesave të parashtruesit.

### **Përmbledhja e fakteve në procedurën gjyqësore**

28. Znj. M. G. pasi kishte shterur të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative, ka parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Pejë, me të cilën ka kërkuar: *“[...] që të anulohet vendimi i të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës në Prishtinë nr. 1604/13 të dt. 31.12.2007 dhe vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, nr. 815/08 të dt. 24.04.2008 si të kundërligjshme dhe të detyrohet e paditura Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës, Agjensioni Pyjor – Zyra Regjionale në Pejë, që paditësen ta kthej në marrëdhënie pune, në punë dhe detyrat e punës që i ka kryer më parë, si përgjegjëse financiare [...]*”.
29. Më 26 prill 2012, Gjykata Komunale në Pejë me Aktgjykimin C. Nr. 340/2008, refuzoi të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses znj. M. G.
30. Në afatin e paraparë ligjor znj. M. G. parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit C. Nr. 340/08, të Gjykatës Komunale në Pejë.

31. Më 14 qershor 2013, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ca. Nr. 3441/2012, refuzoi të pabazuar ankesën e të paditurës znj. M. G. duke vërtetuar Aktgjykimin C. Nr. 340/08, të Gjykatës Komunale në Pejë.
32. Në një datë të pacaktuar, znj. M. G. parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit Ca. Nr. 3441/2012, të Gjykatës së Apelit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të ligjit material.
33. Më 18 dhjetor 2013, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. nr. 287/2013, aprovoi, si të bazuar, revizionin e paditëses znj. M. G., dhe vendosi për ndryshimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ca. nr. 3441/2012, të 14 qershorit 2013 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë, C. nr. 340/2008, të 26 prillit 2012.
34. Duke iu referuar pjesës së vendimit për pranimin, si të bazuar të revizionit, Gjykata Supreme arsyetoi:

*“[...] gjykatat e instancës më të ulët mbi gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të drejtë, të drejtën materiale e kanë zbatuar në mënyrë të gabuar kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar në pjesën që ka të bëjë me obligimin e të paditurës që paditësen ta kthejë në marrëdhënie pune, në punët dhe detyrat e punës që i ka kryer më parë si përgjegjëse financiare.*

*Paditësja te e paditura ka punuar që nga data 5. 4. 2001 në kohë të caktuar, në punët dhe detyrat e përcaktuara sipas përgatitjes profesionale. Punët të cilat i ka kryer paditësja në vendin e punës Zyrtare për çështje ekonomiko – financiare nuk kanë karakter të natyrës së përkohshme apo të kohë pas kohëshme, por të natyrës së përhershme, çka rezulton se në atë vend të punës është pranuar person tjetër.*

*Faktin se, mos vazhdimi të kontratës i ka paraprirë vlerësimi negativ i kryerjes së detyrave të punës nga ana e Shefit të Zyrës së AKP-së, Gjykata Supreme vlerësoi, por sipas nenit 12 të Urdhëresës Administrative nr. 2003/2 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, vlerësimi i punës së çdo nëpunësi civil i nënshtrohet një diskutimi zyrtar së bashku me vlerësimin e menaxherit të saj në baza vjetore si dhe me miratimin e mëposhëm të menaxherit më të lartë në përputhje me procedurat e vlerësimit të punës që do ti përcaktoi ministria, ndërsa sipas nenit 13 të Ligjit të cekur, organi i punësimit duhet të siguroi aftësim adekuat për nëpunësit civil përfshirë edhe vlerësimin e përmbushjes së detyrave.*

35. Duke iu referuar pjesës së vendimit me të cilin çështja kthehet në rigjykim, Gjykata Supreme arsyetoi:

*“[...] Sa i përket pjesës që ka të bëjë me obligimin e të paditurës që paditëses t’ia kompensojë pagën sikur të jetë në marrëdhënie pune prej 1.1.2008 e tutje, dhe lidhur me caktimin e kamatës në shumën e cekur, për shkak të*

*zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt dhe për këtë arsye nuk ka kushte për ndryshimin e aktgjyqimit, kështu që dy aktgjyqimet e gjykatave të instancës më të ulët në këtë pjesë janë prishur dhe lënda i është kthye gjykatës së shkallës së parë për rigjykim [...]”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

36. Parashtruesi i kërkesës pretendon “[...] se Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar gabimisht se në rastin e paditëses kemi të bëjmë thjesht me mosvazhdimin e kontratës së punës, kjo nuk qëndron fare, sepse mosvazhdimin i ka paraprirë masa paraprake e organit kompetent të paditurës, Komisionit Disiplinor, i cili duke shqyrtuar kërkesën për zhvillim të procedurës disiplinore ndaj saj, konform dispozitave në fuqi ka marrë vendim meritor kur e ka shpall përgjegjëse dhe i ka shqiptuar masën adekuate – ndërprerje e marrëdhënies së punës. Zaten këtu qëndron poenta kryesore e kësaj kërkesë drejtuar këtij institucioni të respektuar të Republikës së Kosovës, që është përgjegjëse për interpretimin e çdo dispozite ligjore nga të gjitha lëmitë e jetës, në kushtet dhe rrethanat specifike ekzistuese në Kosovë”.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

37. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

39. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) i Rregullores së punës, parasheh:

(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar..

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

40. Gjykata, në rastin konkret vëren se parashtruesi ankohet kryesisht përkitazi me vlerësimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar të ligjit material (ligjshmërinë) dhe në asnjë mënyrë nuk argumenton pretendimin e tij në baza

kushtetuese (*Shih pretendimet e parashtruesit në paragrafin 35 të këtij dokumenti*).

41. Gjykata vëren se, pretendimet e parashtruesit të cekura më lart janë të natyrës së ligjshmërisë, për të cilat Gjykata vlerëson se bien në kompetencë të plotë të Gjykatës Supreme, e cila sipas detyrës zyrtare ka vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve të instancave më të ulëta.
42. Për më tepër, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me aktgjykimin e nxjerrë nga Gjykata Supreme. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyra e Gjykatës është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato dëshmi (*Shih, rasti Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87 Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991*).
43. Në rastin konkret, Gjykata nuk konsideron që procedurat në Gjykatën Supreme, kanë qenë të njëanshme ose në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009*).
44. Sa i përket pjesës së vendimit me të cilin çështja kthehet në rigjykim, Gjykata vlerëson se rasti është ende në pritje për t'u zgjidhur në procedurë të rregullt gjyqësore (*shih arsyetimin e aktgjyimit të Gjykatës Supreme në paragrafin 33 të këtij dokumenti*).
45. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesi nuk argumentoi pretendimin në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar dëshmi që tregojnë, si dhe pse, të drejtat dhe liritë e tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur me vendimin e kontestuar.
46. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe rregullin 36 (2) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d), 36 (2) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 11 shkurt 2015, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani